



SHPLLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS ME KOHË TË PACAKTUAR

Titulli: Statisticient i ri – Sektori i Statistikave Monetare
Departamenti: i Statistikës
Grada: 7
Raporton tek: Drejtori i Departamentit të Statistikës

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Zbaton programin afatshkurtër të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të njësisë së statistikave monetare e financiare;
- Mbledhë, përpilon dhe validon statistikat monetare dhe financiare me qëllim të rritjes së cilësisë dhe përfshirjes të funksionit statistikor në BQK në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Përgatitë statistikat për publikime periodike e jo periodike në pajtueshmëri me politikën e publikimeve dhe me përvojat më të mira lidhur me shpërndarjen e informatave statistikore;
- Jep mendime dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpilimin, validimin dhe publikimin e informatave statistikore;
- Propozon dhe merr pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e procedurave të punës si dhe dokumenteve tjera administrative të Departamentit të Statistikës;
- Mbanë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët lidhur me çështjet statistikore;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e matematikës ose statistikës. Niveli i përfunduar i studimeve pasuniversitar është përparësi;
- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe/ose serbe dhe në gjuhën angleze;
- Të ketë aftësi të mira për të punuar i pavarur, si dhe për të qenë konstruktivë në punë ekipore, kur afatet kohore janë të ngushta dhe oraret janë paplanifikuara;
- Kandidati që ka njohuri të mira në zbatimin e teknikave moderne statistikore ka përparësi;
- Kandidati duhet të ketë vetiniciativë, aftësi të mira të komunikimit dhe koordinimit.

Përvoja e kërkuar:

- Së paku një vit përvojë pune në statistika apo në sektorin financiar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust apo ATK;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **08 shkurt 2021**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**